



VENDIM

Nr. 42 Datë 22.04.2011

**PËR
MIRATIMIN E “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES DHE FATURIMIT
TË DËMIT EKONOMIK”**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 51 pika 14, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, VKM nr. 338, datë 19.03.2008 “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Bordi i Komisionereve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.04.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e CEZ Shperndarje sh.a për miratimin e “Metodologjisë së Llogaritjes dhe Faturimit të Dëmit Ekonomik.”

Vendosi:

1. Miratimin e “Metodologjisë së Llogaritjes të Dëmit Ekonomik shkaktuar Kompanisë Shpërndarëse nga çdo ndërhyrje e paligjshme.” (bashkëlidhur këtij vendimi).
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë CEZ Shperndarje sh.a për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.